

PRANUAR 30.03 2023

Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
04	400/01	15253	



REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna Drenas/Glogoc
Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim



NJOFTIM

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ka marrë vendim për zgjatjen e afatit për aplikim për pagesa direkte/subvencione për kulturat bujqësore për vitin 2023, nga data 30 mars deri me 06 prill 2023 në ora 16:00.

Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Komuna Drenas për shkak të numrit të madh të kërkesave nga fermerët (bujqit) dhe për mbarëvajtjen e punës me rregull është detyruar të caktojë termine për aplikim nga ana e fermerëve (bujqëve), termine këto të caktuara deri me datën 14.04.2023.

Bazuar në vendimin e Ministrisë për caktimin e afatit si më lartë, njoftojmë të gjithë ata fermer të cilëve iu është caktuar termini pas datës 06 prill 2023 të paraqiten në Drejtorinë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural më së largu deri me datën 06 prill 2023 për aplikim për pagesa direkte/subvencione për kulturat bujqësore.

Faleminderit për mirëkuptim!



Ahmet Ahmeti
Zyrtar i lartë për planifikim dhe projekte